



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 868/4 Prot.

Fier, më 11.09. 2024

**NJOFTIM**  
**PËR SHPALLJEN E PROCEDURAVE TË KONKURSIT PËR KANDIDATË TË**  
**SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL**

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social", i ndryshuar si dhe sipas shkresës nr 2746 prot. dt 11.09.2024 të AKAP Tiranë, DRAP Fier shpall konkursin për kandidatët e interesuar për vendet vakante në shërbimin psikosocial pranë institucioneve arsimore.

**I. Kriteret për t'u punësuar në shërbimin psiko-social:**

**A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë padënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative, apo vërejtje në fuqi.

**B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:**

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse.  
*Psikologu: Diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, ose ekuivalente në fushën e psikologjisë së edukimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015;*  
*Punonjësi social duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe diplomë të ciklit të dytë ose ekuivalente në fushën e punës sociale në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015.*
3. Njohuri bazë në kompjuter.
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata).

5. Aftësi komunikuese dhe punë në grup.

**II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

**A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale –Jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 **(e detyrueshme)**;
2. Kërkesë për (pjesëmarrje në konkurrim) për punësim në zyrën arsimore ku dëshirojnë të aplikojnë për pozicionin psikolog / punonjës social **(e detyrueshme)**;
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit **(i detyrueshëm)**;
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e Diplomës/diplomave (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit), **(e detyrueshme)**;
5. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master **(e detyrueshme)**;
6. Leje për ushtrimin individual të profesionit -kopje e njehsuar me origjinalin **(licencë)**;
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga aplikanti sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 **(e detyrueshme)**;
8. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 **(e detyrueshme)**;
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës së arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
10. Librezë pune fotokopje e noterizuar nëse ka;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e tre muajve të fundit **(e detyrueshme)**;
12. Dëshmi penaliteti **(e detyrueshme)**;
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar **(e detyrueshme)**.

**B.** Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara. Nëse në dosjen e aplikimit mungon një nga dokumentat e detyrueshme, atëherë kandidati skualifikohet automatikisht.

**C.** Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier, për të gjithë kandidatët që aplikojnë për punësim në ZVAP-et në varësi të DRAP Fier, përkatëse brenda afatit 11.09.2024- 16.09.2024.

**III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social të paraqitur në dosje, do të kryhet nga komisioni në periudhën 16.09.2024–18.09.2024.**

- Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor dhe në faqet zyrtare të ZVAP-ve dhe DRAP Fier, në datë 18.09.2024;
- Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Fier ([DRAPFier@arsimi.gov.al](mailto:DRAPFier@arsimi.gov.al)) brenda datave 19.09.2024- 21.09.2024.

- Shpallja e listës përfundimtare e kandidatëve që kalojnë fazën e parë brenda datës 23.09.2024.
  - Brenda datës 23.09.2024 DRAP Fier, njofton nëpërmjet faqes zyrtare lidhur me mjedisin, vendin dhe orën e zhvillimit të testimit.
- IV. Testimi me shkrim për vlerësimin e njohurive të profesionit dhe për njohuritë mbi legjislacionin që lidhet me ushtrimin e profesionit, për kandidatët që kanë kaluar vlerësimin me dosje, do të zhvillohet në datën **24.09.2024, ora 10:00**.
- V. DRAP Fier shpall listën paraprake të kandidatëve të kualifikuar, në datën 25.09.2024.
- VI. Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat për vlerësimin me shkrim në adresën zyrtare të DRAP Fier ([DRAPFier@arsimi.gov.al](mailto:DRAPFier@arsimi.gov.al)), brenda datës 25.09.2024.
- VII. DRAP Fier shpall listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar dhe grafikun e intervistave të strukturuar me kandidatët që janë kualifikuar me testimin me shkrim me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim, pas shqyrtimit të ankesave në datën 25.09.2024.
- VIII. Intervista me kandidatët e kualifikuar në 2 fazat e para do të reazohet në ambientet e DAP Fier në datat 26.9.2024 – 27.09.2024.
- IX. Në përfundim të intervistës, komisioni AD-HOC shpall listën e kandidatëve për psikologë dhe listën e kandidatëve për punonjës-social në nivel DRAP-i, të renditur sipas pikëve gjithsej, (pikët e dosjes + pikët e testimit + pikët e intervistës). Lista me rezultatet përfundimtare i dorëzohet drejtorit të DRAP-it, i cili e publikon me ID përkatëse në faqen e institucionit brenda datës 30.09.2024.
- X. DRAP Fier fillon procedurat e punësimit të kandidatëve sipas renditjes, pas shpalljes së listës përfundimtare.

Lista e vendeve vakante për punonjësit e SHPS do të publikohet në vazhdimësi.

**DREJTORI**

**Zaira Gjika**

